



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:027470
Datë: 18.03.2021
Numri i dokumentit: 01609349

PPP.nr.551/20

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Durim Balaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores F.S nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fadil Sinanaj, avokat në Gjilan, rruga “Bulevardi i Pavarësisë”, H-35, K-II, numër 4, kundër debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës SHSKUK- Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, për kompensimin e pagave jubilarë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të paraqitur kundër Urdhrit përmbarimor P.nr.1102/20 i datës 27.11.2020, i caktuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat G.GJ, për territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, jashtë seancës, me 17 mars 2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës SHSKUK- Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, i paraqitur kundër urdhrin përmbarimor P.nr.1102/20 i datës 27.11.2020, i caktuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat G.GJ për territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë.

II. Ankesa e paraqitur nuk e ndal ekzekutimin e këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat G.GJ, për territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të kreditores F.S nga Gjakova ka caktuar urdhrin për përmbarim në bazë të dokumentit përmbarimor - Vendimi i Inspektoratit të Punës nr.555/2020, datë 09.06.2020, i cili është dokument përmbarimor dhe paraqet bazë për lejimin e përmbarimit sipas nenit 21 dhe 22 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit ë Procedurës Përmbarimore (tutje LPP).

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor me datë 02.12.2020 prapësim ka paraqitur debitori Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës SHSKUK- Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, në të cilin ka parashtruar se procedura përmbarimore është iniciuar në kundërshtim me nenin 71 paragrafi 1, pika

dokumentit:

1, nënpika 1.1 të LPP-së, për shkak së Përmbaruesi Privat ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes materiale, duke mos e cekur se në cilat prova është bazuar dhe ka kërkuar që të bëhet pagesa për 3 (tre) paga jubilarë në vlerë prej 1,438.62 €, pasi që në vendimin numër 555/2020, datë 09.06.2020, nuk është caktuar shuma e mjeteve monetare, të cilat debitori duhet të ia paguaj kreditorës. Ka shtuar se dokumenti në bazë të te cilit është lejuar përmbarimi nuk mund të paraqitet si dokument ekzekutiv dhe nuk është i përshtatshëm për përmbarim, ashtu siç kërkohet me nenin 27 paragrafi 1 të LPP-së, ku parashihet se “Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, e që në këtë vendim në dispozitivin e tij nuk është cekur asnjë shumë e të hollave, andaj urdhri për përmbarim është lejuar në kundërshtim me nenin 71 dhe 73 paragrafi 3 të LPP-së. Po ashtu ka theksuar se me Ligjin për Zyrtarët Publik, në nenin 74 paragrafi 5, parashihet se nëpunësit e shërbimit publik për çdo pakënaqësi me vendimet e organit të ankimit, gjegjësisht punëdhënësit udhëzohen ti drejtohen Gjykatës kompetente, e jo Inspektoratit të Punës, që do të thotë se kjo e drejtë nuk është në përgjegjësinë e Inspektoratit të Punës, mirëpo është në përgjegjësinë e Gjykatës. Po ashtu, në prapësim ka parashtruar se urdhri për përmbarim është paraqitur në kundërshtim me nenin 144 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që akti administrativ hyn në fuqi dhe bëhet i ekzekutueshëm nga vet organi administrativ i cili e ka nxjerrë këtë vendim, ndërsa vendimi në bazë të cilit është lejuar përmbarimi nuk është bërë ende i ekzekutueshëm, pasi që debitori e ka pranuar vendimin e inspektoratit të punës me datë 27.11.2020, ndërsa sipas këshillës juridike, pala e pakënaqur ka të drejtë në kontestimin e vendimit në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit, e të cilën të drejtë debitori do ta shfrytëzoj duke ushtruar padi për konfliktin administrativ. Me propozim për gjykatën që ta aprovoj prapësimin e debitorit si të bazuar, ndërsa propozimi për përmbarim dhe urdhri për përmbarim P.nr.1102/20 i datës 27.11.2020 të anulohen si të kundërligjshëm.

Kreditorja përmes të autorizuarit të saj, brenda afatit ligjor me datë 14.12.2020 ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, në të cilin ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim ngase Përmbaruesi Privat me rastin e lejimit të urdhrin për përmbarim është mbështetur në vendimin nr.555/2020, datë 09.06.2020, i cili vendim është i formës se prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 02.09.2020, e me të cilin dihet saktë së në numrin rendor 329 kreditorë është F.S, ndërsa debitor është Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës SHSKUK - Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë. Ka shtuar së vendimin në bazë të cilit është lejuar përmbarimi është plotësisht në pajtueshmëri me dispozitat e LPP-së, konkretisht me nenin 22 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe nenin 23 paragrafi 2 të LPP-së, ndërsa në bazë të nenit 27 të LPP-së, është i përshtatshëm për përmbarim. Në përgjigje në prapësim po ashtu ka theksuar se nuk qëndron pretendimi i debitorit lidhur me atë së me nenin 74 paragrafi 5 të Ligjit për Zyrtarët Publik është paraparë së nëpunësit e shërbimit publik për çdo pakënaqësi me vendimet e organit të ankimit udhëzohen ti drejtohen Gjykatës kompetente e jo inspektoratit të punës, ngase për punëtorët shëndetësor aplikohet Ligji i Punës, konkretisht neni 2 paragrafi 1 dhe neni 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, ndërsa me Ligjin për Zyrtarët Publik, në nenin 2 paragrafi 4 parashihet se ky ligj aplikohet për personelin administrativ dhe nivelin e lartë drejtues të cilët punojnë në shëndetësi, e nuk zbatohet për mjekët apo infermierët të cilët kryejnë shërbime profesionale shëndetësore. Po ashtu, me nenin 62 paragrafi 6, të Ligjit për Shëndetësinë është

dokumentit:

paraparë së “Të punësuarit në SHSKUK nuk i takojnë shërbimit civil të Kosovës”, që nënkupton se nuk i takojnë as ligjit për zyrtarët publik, i cili është pasardhës i Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës. Për fund ka shtuar se pretendimet lidhur me ekzekutueshmerinë dhe ngritja e kontestit administrativ nuk qëndrojnë, për faktin se vendimi në bazë të cilit është lejuar përmbarimi konform nenit 6 paragrafi 4 të Ligjit nr.2002/9 dhe 03/L-017 për Inspektoratin e Punës, i njëjti është bërë i ekzekutueshëm dhe se ngritja e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij vendimi. Me propozim për gjykatën që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të detyrohet debitori në pagimin e shpenzimeve të procedurës sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, urdhrit përmbarimor dhe prapësimi të paraqitur nga debitori, si dhe vlerësimit të përgjegjës në prapësim, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se caktimi i përmbarimit është bërë duke u bazuar në Vendimin e Inspektoratit të Punës nr.555/2020, datë 09.06.2020, me të cilin vendim është detyruar që debitori t’ia paguaj kreditores borxhin në shumë prej 1,438.62 € në emër të shpërblimit jubilar dhe atë për 30 vite të përvojës së punës.

Gjykata ka vlerësuar Vendimin e Inspektoratit të Punës nr.555/2020, datë 09.06.2020, i ekzekutueshëm nga data 02.09.2020, në bazë të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe vlerëson së ky vendim i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 21, 22 par.1 pika 1.2, 23, 24 paragrafi 3 dhe 27 të LPP-së, për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës SHSKUK- Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, lidhur me atë se dokumenti në bazë të te cilit është lejuar përmbarimi nuk i përmban elementet e kërkuara sipas nenit 27 të LPP-së, mirëpo ky pretendim ishte i pabazuar, ngase gjykata pas shikimit të dokumentit përmbarues të lartcekur, erdhi në përfundim se i njëjti i përmban të gjitha elementet e kërkuara me dispozitën e sipërcituar, ngase sipas nenit 27 të LPP-së, parashihet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, tutje në paragrafin 2 të këtij neni, parashihet se *“Në qoftë se me anë të dokumentit përmbarues nuk është caktuar afati për përmbushje vullnetare të detyrimit, afati i tillë do të caktohet me anë të aktvendimit për përmbarimin, dhe urdhrit për përmbarim, për shtatë (7) ditë”*, e që sipas vlerësimit të gjykatës ky vendim i përmban të gjitha elementet e kërkuara sipas dispozitës së lartcekur.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit lidhur me kompetencën e Inspektoratit të Punës për të vendosur lidhur me ankesën e kreditores dhe erdhi në përfundim se një pretendim i tillë është i pambështetje ligjore, ngase në këtë procedurë kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit dhe përmbajtjes së tij, sepse i njëjti pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë

dokumentit:

së vendimit objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Përfundimisht, gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e debitorit lidhur me mundësinë e inicimit të konfliktit administrativ ndaj vendimit objekt përbarimi, mirëpo edhe ky pretendim ishte pa mbështetje ligjore, ngase me nenin 22 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, parashihet se *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*, andaj mbi këtë bazë edhe ky pretendim ishte i pabazuar.

Andaj, pas vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, e meqenëse debitori nuk ka ofruar prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 61 e lidhur me nenin 69 par. 4 të LPP-së, dhe nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përmbaruesit Privat apo shtyrjen e zbatimit të përbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 71 par 1, pika 1 deri në pikën 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës, kjo gjykatë vendosi që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi të pabazuar.

Gjykata vendosi sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 74 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, ku parashihet se *“Vendimi kundër të cilit është refuzuar prapësimi bëhet i përmbarueshëm, e po që se kundër tij nuk lejohet ankesa, ai bëhet i formës së prerë”*, andaj mbi këtë bazë ankesa e paraqitur nuk ndalon ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Për këto shkaqe dhe arsye sipas dispozitës së nenit 73 par.3 të LPP-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke refuzuar prapësimin e ushtruar ndaj urdhrit për përbarim P.nr.1102/20 i datës 27.11.2020.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.551/20, datë 17 mars 2021.

Numri i lëndës: 2021:027470

Gjyqtari
Durim Balaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.